

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA-KOSOVA CUMHURIYETI  
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare  
Glavni Centar za Porodično Zdravstvo  
Aile Hekimligi Genel Merkezi

Nr.Br.No. 2013

Më,Dt. 17.01.2024

P R I Z R E N



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

DREJTORIA KOMUNALE E SHËNDETËSISË

# RAPORTI VJETOR I PUNËS I DREJTORISË KOMUNALE TË SHËNDETËSISË 2023

Drejtoria e Shëndetësisë, gjatë periudhës janar - dhjetor 2023, ka realizuar një numër të konsiderueshëm aktiviteteve dhe punësh të cilat i ka pasur të planifikuara me planin e punës për vitin 2023.

DKSH përveç se ka ofruar shërbimet e rregullta shëndetësore për pacient përmes QKMF-së, në aspektin procedural ka filluar me procedurat e nevojshme për realizimin e projekteve të parapara, duke parashtruar kërkesat tek zyra e Kryetarit për marrjen e vendimeve përkatëse lidhur me projektet si dhe ka përpiluar specifikacionet dhe paramasat për projektet e parapara dhe pas marrjes së vendimeve përkatëse nga ana e Kryetarit, janë hapur procedurat e tenderimit, ku më pas janë nënshkruar kontratat përkatëse për këto projekte dhe janë kryer furnizimet, punët ose shërbimet sipas këtyre kontratave.

Për projektet të cilat kanë qenë në fuqi kontratat nga vitet e kaluara, kanë vazhduar punët, furnizimet apo shërbimet sipas atyre kontratave.

Gjatë kësaj kohe, janë pranuar kërkesat për mbështetje financiare për kategoritë e përcaktuara me rregulloren për ndarjen e subvencioneve si dhe janë realizuar pagesat për këto kategori, sipas kërkesave të parashtruara.

Më poshtë gjeni pasqyrën e projekteve, aktiviteteve, shërbimeve, etj., të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe në kuadër të DKSH.

## **PROJEKTET, AKTIVITETET, SHËRBIMET DHE PUNËT E PLANIFIKUARA DHE TË KRYERA NGA DKSH GJATË VITIT 2022**

### **INVESTIMET KAPITALE**

<b>Emri i projektit</b>	<b>Statusi i realizimit</b>	<b>Vërejtje</b>
Furnizim me paisje stomatologjike	Realizuar	Është shpallur për herë të dytë për të realizuar buxhetin e paraparë për 2023, të mbetur nga kontrata e parë
Furnizim me paisje laboratorike	Realizuar	Është shpallur për herë të dytë për të realizuar buxhetin e paraparë për 2023, të mbetur nga kontrata e parë
Furnizim me Autoambulanca	Në procedurë tenderuese	Nuk ka pasur asnjë ofertues të përgjegjshëm në procedurën tenderuese në herën e parë, është rishpallur
Ndërtimi i QMF në fshatin Korishë	Në proces të realizimit	Pothuajse në përfundim, kontratë 2 vjeçare
Ndërtimi i QKMF në KFOR	Në proces të realizimit	Kontratë 3 vjeçare



Ndërtimi i aneksit të QMF-së në fshatin Gjonaj	Në proces të realizimit	Nuk ka
Ndërtimi i aneksit të QMF-së në fshatin Zhur	Në proces të realizimit	Nuk ka
Ndërtimi i aneksit të QMF-së në fshatin Reqanë	Në proces të realizimit	Nuk ka
Ndërtimi i aneksit të QMF-së në lagjen Dardania	Në proces të realizimit	Nuk ka
Digjitalizimi i shërbimeve të urgjencës	Në procedurë tenderuese	Është rivlerësuar pas ankesës në OSHP dhe vendimit nga ky organ për rivlerësim
Blerja e tavolinave, karrigeve, dollapave dhe materialeve të tjera për përmbushjen e nevojave të inverterit të KPSH	Realizuar	Nuk ka
Blerja e aparaturave mjekësore	Realizuar	Është shpallur për herë të dytë për të realizuar buxhetin e paraparë për 2023, të mbetur nga kontrata e parë
Blerja e aparaturave për trajnim të stafit mjekësor	Pezulluar	Nuk ka pasur nevoja të tilla për këtë vit
Blerja e aparaturave jo mjekësore	Realizuar	Nuk ka

### MALLRAT DHE SHËRBIMET

Emri i projektit	Statusi i realizimit	Vërejtje
Furnizim me reagenca laboratorike	Në realizim e sipër	Kontratë kornizë 12 mujore
Furnizim me material shpenzues sanitar	Në realizim e sipër	Kontratë kornizë 12 mujore
Furnizim me barna	Në procedurë tenderuese	Lënda në OSHP, për mbulim të nevojave është hapur një procedurë tjetër tenderuese me vlerë të vogël dhe në marrjen e vendimit nga OSHP
Furnizim me filma të RTG	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 2 vjeçare
Furnizim me material stomatologjik	Në procedurë tenderuese	Nuk ka
Furnizim me Uniforma të punës (Projekt nga viti i kaluar)	Realizuar	Nuk ka
Furnizimi me libreza sanitare	Në procedurë tenderuese	Nuk ka pasur ofertues
Furnizimi me material higjienik	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 2 vjeçare
Furnizimi me material administrativ	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Furnizimi me dru dhe pelet	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore



Furnizimi me oksigjen (gaz medicinal)	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Furnizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e programit të faturimit të shërbimeve shëndetësore	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 2 vjeçare
Furnizimi montimi dhe mirëmbajtja e kamerave nëpër objektet e KPSH	Në procedurë tenderuese	Është rivlerësuar pas ankesës dhe vendimit nga OSHP
Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për mbulimin e kërkesave dhe nevojës për staf shtesë të QKMF-së (Projekt nga viti i kaluar)	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 3 vjeçare e bartur nga viti i kaluar
Trajnimet e stafit mjekësor	Në procedurë tenderuese	Nuk ka pasur ofertues
Sigurimi fizik i Objekteve të KPSH (Projekt nga viti i kaluar)	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Dezinfektimi, DDD	Realizuar	Nuk ka
Furnizimi me shujta ditore për profesionistët shëndetësor që merren me realizimin e vizitave sistematike	Realizuar	Nuk ka
Furnizimi dhe montimi i tabelave LED për objektet e KPSH	Në proces të realizimit	Nuk ka
Mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve të KPSH	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 2 vjeçare
Adaptimi i hapësirave të vaksinimit	Realizuar	Nuk ka
Mirëmbajtja e paisjeve teknike	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 2 vjeçare
Mbushja dhe servisimi i aparateve kundër zjarrit (Projekt nga viti i kaluar)	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 2 vjeçare
Mirëmbajtja e oborreve të objekteve të KPSH (Projekt nga viti i kaluar)	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 3 vjeçare
Furnizimi me vula ër QKMF, QMF, AMF	Në proces të realizimit	Pritet furnizimi sipas kontratës
Furnizimi me ID kartela për puntorët e QKMF	Në proces të realizimit	Pritet furnizimi sipas kontratës
Mbikëqyrja e projekteve ndërtimore të DKSH	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 3 vjeçare
Servisimi i automjeteve	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 2 vjeçare
Pastrimi dhe mirëmbajtja e automjeteve	Në proces të realizimit	Kontratë kornizë 12 mujore
Realizimi i puntorisë lidhur me të gjeturat gjatë vizitave sistematike	Realizuar	Nuk ka
Dislokimi i shtyllave elektrike tek parcella ku po ndërtohet QMF e re në Korishë	Realizuar	Nuk ka



## SHËRBIMET SHËNDETËSORE

Emri i shërbimit	Statusi i realizimit	Vërejtje
Vizitat specialistike mjeksore	Realizuar	Nuk ka
Shërbimi i vaksinimit të rregullt	Realizuar	Nuk ka
Shërbimi i vaksinimit kundër Covid-19	Realizuar	Nuk ka
Shërbimi diagnostik – analizat laboratorike	Realizuar	Nuk ka
Shërbimi diagnostik – radiologjik	Realizuar	Nuk ka
Shërbimi i njësisë diabetike	Realizuar	Nuk ka
Shërbimi urgjent	Realizuar	Nuk ka
Shërbimet geriatrike	Realizuar	Nuk ka
Shërbimet e kujdesit paliativ	Realizuar	Nuk ka
Shërbimet e vizitave të mjekut në shtëpi		Nuk ka
Shërbimet mjeksore nga ndërrimi i tretë (24h)	Realizuar	Nuk ka
Shërbimet stomatologjike	Realizuar	Nuk ka
Realizimi i testeve rapise për detektimin e Covid-19	Realizuar	Nuk ka
Shërbimet shëndetësore si EKG, Inhalime, fashime, injeksione, infuzione, etj.	Realizuar	Nuk ka
Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë	Realizuar	Nuk ka
Këshillime, udhëzime, etj	Realizuar	Nuk ka

## AKTIVITETET E REALIZUARA NË FORMË TË CHECK-UP

Emri i Check-up	Statusi i realizimit	Vërejtje
Check up për zbulimin e sëmundjes së Diabetit	Realizuar	Nuk ka
Check up për sëmundjet e gjëndrrës tiroide	Realizuar	Nuk ka
Check up për zbulimin e sëmundjeve të kancerit të gjirit	Realizuar	Nuk ka
Check up për zbulimin e sëmundjeve të mëlqisë dhe pankreasit	Realizuar	Nuk ka

## SHËNIMI I DITËVE BOTËRORE

Emri i Ditës Botërore	Statusi i Realizimit	Vërejtje
Dita Botërore e Kancerit	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore e TBC	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore e Infermierit	Realizuar	Nuk ka
Java botërore e Imunizimit	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore e Hipertensionit	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore e Mjekut Familjar	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore e Duhanit		Nuk ka
Dita Botërore kundër abuzimit të drogave	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore e Zemrës	Realizuar	Nuk ka
Muaji i Kancerit të Gjirit	Realizuar	Nuk ka
Dita Botërore e Diabetit	Realizuar	Nuk ka

## AKTIVITETE TË TJERA

Emri i aktivitetit	Statusi i realizimit	Vërejtje
Shpërndarja e mirënjohjeve për puntorët e QKMF për punën gjatë vitit 2022	Realizuar	Nuk ka
Pranimi i donacionit me paisje mjekësore nga KFOR-i Italian	Realizuar	Nuk ka
Pranimi i donacionit me paisje mjekësore nga AQH	Realizuar	Nuk ka
Zgjerimi i projektit të vizitave shtëpiake të mjekut për të gjitha kategoritë e personave që e kanë të pamundur çasjen fizike në objektet shëndetësore të KPSH	Realizuar	Nuk ka
Organizimi i puntorisë lidhur me të gjeturat gjatë vizitave sistematike të nxënësve nëpër shkollat e Komunës së Prizrenit	Realizuar	Nuk ka

## SUBVENCIONET


Emri i projektit	Statusi i realizimit	Vërejtje
Mbështetja financiare e personave të sëmurë me CA, Tumore, puntorët e administratës komunale me sëmundje të rënda si dhe fëmijët deri në 18 vjet me sëmundje metabolike, paralizë cerebrale, diabet insulinivartës.	Realizuar	Nuk ka




Në vijim do të shpalojmë raportin e detajuar për secilin projekt, shërbim dhe aktivitet të realizuar nga DKSH.

DKSH, për vitin fiskal 2023 ka pasur në dispozicion buxhetin prej **6,696,857.66** eurosh, i cili ka qenë i dedikuar për kategoritë e pagave dhe mëditjeve, investimeve kapitale, mallrave dhe shërbimeve dhe komunalive. Buxheti i shpenzuar për kategorinë e subvencioneve për kërkesat drejtuar DKSH për mbështetje financiare, është realizuar nga mjetet të cilat kanë qenë nën menaxhimin e zyrës së Kryetarit të Komunës.


Nga shuma totale e buxhetit të planifikuar, DKSH ka shpenzuar rreth **107.53 %** të buxhetit në të gjitha kategoritë, kjo duke llogaritur shtesën jashtë planifikimit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve si shkak i rritjes së koeficientit të pagave. Në grafikonin e mëposhtëm mund të gjeni pasqyrën e saktë të shpenzimit të këtyre mjeteve gjatë kësaj periudhe.



Për secilën kategori, ky ka qenë parashikimi i mjeteve për vitin 2023:



Bazuar në kategoritë buxhetore, më poshtë gjeni grafikonin i cili pasqyron shpenzimin dhe mbetjet e mjeteve për këtë periudhë sipas këtyre kategorive. Tek kategoria e pagave dhe mëditjeve, kemi një shpenzim më të madh të buxhetit sesa planifikimi i bërë për vitin 2023, duke u bazuar në faktin se planifikimi është bërë duke u bazuar në pagat pa rritje të koeficientit, ndërsa shpenzimi është bërë me koeficient të rritur.



Në vijim gjeni raportet detale për secilën kategori, përkatësisht projekt.

## 1. Investimet kapitale

Nga kategoria e investimeve kapitale, DKSH ka pasur të planifikuara realizimin e projekteve si më poshtë për vitin 2023:


1. Furnizim me paisje stomatologjike
2. Furnizim me paisje laboratorike
3. Furnizim me autoambulanca
4. Ndërtimi i QMF-së në Korishë
5. Ndërtimi i QKMF-së në KFOR
6. Ndërtimi i aneksit të QMF-së në fshatin Gjonaj
7. Ndërtimi i aneksit të QMF-së në fshatin Zhur
8. Ndërtimi i aneksit të QMF-së në fshatin Reqanë
9. Ndërtimi i aneksit të AMF-së në lagjen Dardani
10. Digjitalizimi i shërbimeve të urgjencës
11. Blerja e tavolinave, karrigave, dollapave dhe materialeve të tjera të nevojshme për përmbushjen e nevojave të inventarit të KPSH
12. Blerja e aparaturave mjekësore
13. Blerja e aparaturave për trajnim të stafit mjekësor
14. Blerja e aparaturave jo mjekësore (elektronike, kamera, gjenerator, teknika e bardhë, etj)




Buxheti i planifikuar për realizimin e këtyre projekteve, ka kapur vlerën e rreth **1,258,812.22** eurosh. Nga ky buxhet janë shpenzuar rreth **74.71%** të këtyre mjeteve.

Më poshtë gjeni të bashkangjitur në mënyrë grafike raportin për shpenzimin dhe mbetjen buxhetore për këtë kategori, si dhe ndarjen e buxhetit nga kjo kategori për secilin projekt si dhe hargjimin dhe mbetjen buxhetore nga këto projekte.

### Buxheti i planifikuar për investime kapitale për vitin 2023.



### Buxheti i planifikuar për projektet veç e veç - kategoria Investime kapitale



## 1.1. Furnizimi me paisje stomatologjike

Për këtë projekt DKSH ka pasur në dispozicion shumën prej 40,000.00 eurosh për vitin 2023.

Me datë 30.05.2023 është nënshkruar kontrata me OE, dhe më pas është bërë furnizimi me paisjet përkatëse sipas kontratës.

Paisjet me të cilat është furnizuar DKSH përmes kësaj kontrate përfshijnë: turbina, kundërkënd, mikromotor me ajër, autoklav me desilator, heliomat, trimer, polir, biglla, motor teknik, lugë për masa metalike, ortometër, etj.

Për për përmbushjen e kësaj kontrate, DKSH ka shpenzuar shumën prej 15,855.00 eurosh.

Duke parë faktin se shumta e shpenzuar ka qenë më e vogël në krahasim me mjetet e parapara për këtë pozicion, DKSH ka shpallur për herë të dytë procedurën për blerjen e paisjeve stomatologjike e cila është në procedura të prokurimit.

Më poshtë gjeni një grafikon lidhur me planifikimin, shpenzimin dhe mbetjen e buxhetit të planifikuar për këtë projekt.



## 1.2. Furnizimi me paisje laboratorike

Për blerjen e këtyre paisjeve, DKSH ka pasur të parapara 35,000.00 euro për vitin 2023.

Me datë 24.05.2023 është nënshkruar kontrata me OE dhe Komunës së Prizrenit, në vlerë prej 23,800.00 eurosh.


Bazuar në kontratën e nënshkruar, është bërë furnizimi përkatës me paisje laboratorike, përfshirë këtu paisjet si aparat automatik biokimik dhe analizator imunologjik.



Pasiqë me kontratën e parë nuk është shpenzuar i gjithë bugjeti i paraparë për këtë projekt, DKSH ka hapur për herë të dytë procedurën e prokurimit, ku me datë 16.11.2023 është nënshkruar edhe kontrata tjetër në vlerë prej 5,900.00 eurosh për blerjen e numëruesit hematologjik 5 diferencial.

Pjesa e mbetur e mjeteve nga ky projekt, është bartur për pagesë tek projekti i QMF Korishë.

Më poshtë gjeni të paraqitur në mënyrë grafike shpenzimin e buxhetit për këtë projekt.



### 1.3. Furnizimi me autoambulanca

Sipas planifikimit, DKSH ka hapur procedurat tenderuese për furnizim me autoambulanca, mirëpo pasiqë nuk ka pasur asnjë operator ekonomik të përgjegjshëm për të lidhur kontratën e paraparë, procedura është rishpallur dhe akoma është në procedurë tenderuese.

Si rrjedhojë, nga buxheti i paraparë prej 100,000.00 eurosh, shuma prej 20,000.00 eurosh është bartur për shpenzim në projektin e ndërtimit të QMF-së në Korishë.


### 1.4. Ndërtimi i QMF në fshatin Korishë

Ky projekt i filluar në vitin e kaluar, është pothuajse në përfundim.


Për këtë vit, DKSH ka pasur të planifikuara 100,000.00 euro për përfundim të këtij projekti, mirëpo sipas punëve shtesë dhe shtesave të inflacionit, kësaj vlere i janë shtuar edhe 96,073.97 euro të cilat janë marrë nga projektet e tjera nga kategoria e investimeve kapitale ku kanë tepruar mjetet e parapara. Kjo rritje është bërë si shkak i nënshkrimit të aneks kontratës për punë shtesë dhe si shkak i faturave për pagesën e inflacionit në produktet ndërtimore, vendim ky i marrë nga Qeveria.



Më poshtë shpalosim shumën e planifikuar, harxhuar dhe të mbetur monetare për këtë projekt.



Këtu gjeni edhe disa fotografi lidhur me projektin në fjalë gjatë ndërtimit në faza të ndryshme.



QMF Korishë




## 1.5. Ndërtimi i QKMF-së në ish kampin e KFOR-it

Ky projekt ka filluar të implementohet që nga viti 2022.

Duke pasur parasysh që është projekt 3 vjeçar, për këtë vit, DKSH ka planifikuar një buxhet prej 540,000.00 eurosh për realizimin e disa fazave të këtij projekti, pasi që komplet realizimi i projektit kap shifrën e rreth 2,323,000.00 eurosh me kontratën fillestare, si dhe punët shtesë të miratuara në vlerë prej 99,646.50 eurosh.

Buxheti i planifikuar është shpenzuar pothuajse në tërësi.


Më poshtë gjeni diagramin lidhur me realizimin e buxhetit të këtij viti për këtë projekt.



Gjithashtu, këtij raporti do t'ia bashkangjijim edhe disa foto lidhur me realizimin e projektit.







QKMF tek ish kampi i KFOR

### **1.6. Ndërtimi i aneksit të QMF-së së fshatit Gjonaj**

Për implementimin e këtij projekti është paraparë shuma prej 50,000.00 eurosh.

Me datë 28.07.2023 është nënshkruar kontrata me OE në vlerë prej 40,000.00 eurosh.

Projekti është në fazën e realizimit dhe deri më tani shuma e shpenzuar deri më tani për këtë projekt kap vlerën e 13,000.00 eurosh.

10,000.00 euro nga ky projekt, janë bartur për shenzim tek projekti i QMF Korishë.

### **1.7. Ndërtimi i aneksit të QMF-së së fshatit Zhur**

Për implementimin e këtij projekti është paraparë shuma prej 50,000.00 eurosh.

Me datë 28.07.2023 është nënshkruar kontrata me OE në vlerë prej 43,915.00 eurosh.

Projekti është në fazën e realizimit dhe deri më tani shuma e shpenzuar deri më tani për këtë projekt kap vlerën e 27,227.00 eurosh.

6,085.00 euro nga ky projekt, janë bartur për shenzim tek projekti i QMF Korishë.

### **1.8. Ndërtimi i aneksit të QMF-së së fshatit Reqanë**

Për implementimin e këtij projekti është paraparë shuma prej 50,000.00 eurosh.

Me datë 21.07.2023 është nënshkruar kontrata me OE në vlerë prej 42,175.00 eurosh.



Projekti është në fazën e realizimit dhe deri më tani shuma e shpenzuar deri më tani për këtë projekt kap vlerën e 31,000.00 eurosh.

7,824.50 euro nga ky projekt, janë bartur për shenzim tek projekti i QMF Korishë.

### **1.9. Ndërtimi i aneksit të AMF-së së lagjes Dardani**

Për implementimin e këtij projekti është paraparë shuma prej 50,000.00 eurosh.

Me datë 26.07.2023 është nënshkruar kontrata me OE në vlerë prej 39,201.50 eurosh.

Për shkak të çështjeve administrative lidhur me lejen ndërtimore, së pari është vonuar fillimi i punimeve e më pas edhe është pezulluar deri në paisjen me leje ndërtimore të objektit.

Shuma e shpenzuar deri më tani për këtë projekt kap vlerën e 30,000.00 eurosh.

10,798.50 euro nga ky projekt, janë bartur për shenzim tek projekti i QMF Korishë.

### **1.10. Digjitalizimi i shërbimeve të urgjencës**

Për këtë projekt janë paraparë gjithsej 160,000.00 euro nga ana e DKSH.

Pas shpajjes së tenderit, fillimisht është anuluar tenderi ngase nuk ka pasur operator ekonomik të përgjegjshëm. Më pas është rishpallur tenderi dhe pas rivlerësimit është shpallur OE fitues, por lënda ka shkuar me ankesë në OSHP dhe bazuar në vendimin e OSHP-së, është rivlerësuar përsëri.

Akoma nuk është lidhur kontratë me OE, dhe rrjedhimisht për këtë projekt buxheti i paraparë nuk është shfrytëzuar fare.

25,285.00 euro nga ky projekt, janë bartur për shenzim tek projekti i QMF Korishë.

### **1.11. Furnizimi me inventar për zyra dhe ordianca shëndetësore**

Për furnizimin me inventar për zyrat dhe ordiancat shëndetësore, DKSH ka paraparë buxhetin prej 50,000.00 eurosh për vitin 2023.

Pas nënshkrimit të kontratës me datë 05.01.2023, është bërë furnizimi sipas kontratës bazuar në kërkesat e njësive shëndetësore për inventar.

Shuma e shpenzuar për këtë projekt është 00000 euro.

Më poshtë gjeni të paraqitur në mënyrë grafike shpenzimin e buxhetit për këtë projekt.



## 1.12. Blerja e aparaturave mjekësore


Për këtë projekt, DKSH ka pasur të ndara gjithsej 50,000.00 euro.  
Me datë 24.08.2023 është nënshkruar kontrata me OE, dhe më pas është bërë furnizimi me paisjet përkatëse sipas kontratës.

Paisjet me të cilat është furnizuar DKSH përmes kësaj kontrate përfshijnë: pulsoksimetër, multi-funksional trolleys, V stands, stetoscope, ambu bag, manometer, set diagnostik, ECG, etj.

Për për përmbushjen e kësaj kontrate, DKSH ka shpenzuar shumën prej 27,750.00 eurosh.

Duke parë faktin se shuma e shpenzuar ka qenë më e vogël në krahasim me mjetet e parapara për këtë pozicion, DKSH ka shpallur për herë të dytë procedurën për blerjen e paisjeve mjekësore e cila është në procedura të prokurimit.

Më poshtë gjeni një grafikon lidhur me planifikimin, shpenzimin dhe mbetjen e buxhetit të planifikuar për këtë projekt.





### 1.13. Blerja e aparaturave për trajnim të stafit mjekësor

Pasiqë nga viti i kaluar QKMF është furnizuar mjaftueshëm me paisje të kësaj fushe, këtë vit është pezulluar furnizimi nga kjo kategori ngase nuk ka qenë i nevojshëm një furnizim i tillë.

Mjetet e parapara për këtë kategori kanë qenë 10,000.00 euro, të cilat janë bartur për shpenzim tek projekti i QMF Korishë.

### 1.14. Blerja e paisjeve jo mjeksore

Për realizimin e blerjes së këtyre paisjeve kanë qenë të planifikuara gjithsej 50,000.00 euro.


Për këtë projekt, fillimisht është zbatuar kontrata e nënshkruar më 19.12.2022, në vlerë totale prej 29,826.00 eurosh.

Më pas, për shpenzimin total të vlerës së parashikuar, DKSH ka hapur rishtazi procedurat e prokurimit, ku me datë 15.11.2023 është nënshkruar edhe kontrata e dytë në vlerë prej 9,305.00 eurosh.

Me datë 21.11.2023 është nënshkruar kontrata për blerjen e klimave për KPSH në vlerë totale prej 7,475.00 eurosh.

Me anë të këtyre kontratave, jemi furnizuar me paisjet si: gjeneratorë, bojlerë, frigoriferë, rrobalarëse, rrobatharëse, hekur për hekurisje, laptop, PC desktop, monitorë, printerë, klima, etj.

Grafikisht, gjeni më poshtë të paraqitur shpenzimin buxhetor për këtë projekt.




## 2. Mallrat dhe shërbimet

Buxheti i planifikuar për projektet të cilat hyjnë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2023, ka qenë i planifikuar që të jetë **1,661,060.00** euro.

Nga ky buxhet, vlera e shpenzuar për këtë periudhë kap vlerën e **1,609,398.04** eurosh, përkatësisht rreth **96.89%** të buxhetit të planifikuar.

Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar, do të dukeshin si më poshtë:



Shumica e projekteve nga kjo kategori, janë projekte të cilat kanë të bëjnë me furnizime të ndryshme, me anë të së cilave mundësohet ofrimi sa më të mirë të shërbimeve shëndetësore dhe të cilat ndikojnë në mbarëvajtjen e punëve të përditshme të institucioneve shëndetësore, përfshirë këtu furnizimet me reagenca laboratorike, me filma rtg, me gaz medicinal, me dru, me pelet, me barna, me material shpenzues sanitar, material higjienik, material administrativ, etj.


Mirëpo ka edhe projekte të shërbimeve dhe punëve siç janë mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve të KPSH, mirëmbajtja e oborreve dhe kopshteve në institucionet e KPSH, ofrimi i shërbimeve shëndetësore për mbulimin e kërkesave dhe nevojës për staf shtesë të QKMF-së, sigurimi fizik i objekteve të KPSH, etj.

Ky buxhet është shpenzuar në vlerat e paraqitura për disa nga projektet e ndryshme sipas grafikonit të mëposhtëm:




## Buxheti i shpenzuar sipas projekteve

■ Buxheti i shpenzuar sipas projekteve







Më poshtë do të bashkangjesim disa fotografi lidhur me realizimin e disa projekteve nga kjo kategori, siç janë mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve shëndetësore, mirëmbajtja e oborreve të objekteve të KPSH, adaptimi i hapësirave të vaksinimit, etj.














### 3. Komunalitë

Për mbulimin e shpenzimeve komunale, përfshirë këtu furnizimin me ujë, furnizimin me rrymë, mbledhjen e mbeturinave, etj, nëpër të gjitha institucionet e shëndetësisë primare, përfshirë QKMF-në, QMF-të, AMF-të në Komunën e Prizrenit, DKSH ka shpenzuar gjithsej **149,404.45** euro, nga gjithsej **150,000.00** euro të planifikuara për këtë kategori, ose shprehur në përqindje rreth **99.60%**.

Buxheti i shpenzuar dhe i mbetur, do të dukeshin si më poshtë:




## 4. Shërbimet shëndetësore

Gjatë periudhës janar-nëntor 2023, DKSH përmes QKMF-së ka ofruar një numër të madh të shërbimeve shëndetësore. Ky numër arrin shifrën e rreth **823,409** shërbime shëndetësore, duke përfshirë por mos kufizuar në shërbimet si: vizita specialistike mjekësore, vaksinim, analiza laboratorike, rtg, shërbime urgjente, shërbime geriatrike, shërbime të kujdesit paliativ, shërbime stomatologjike, vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë, teste rapide, EKG, fashime, inhalime, injeksione, infuzione, këshillime, udhëzime, etj.

Më poshtë do të shpalosim numrin e disa prej shërbimeve të ofruara, duke dhënë statistika mujore për numrin e realizuar të këtyre shërbimeve nëpër institucionet shëndetësore.

### 4.1. Vizitat mjekësore


Në total janë realizuar gjithsej **453,653** vizita mjekësore të cilat përgjatë muajve janë realizuar si më poshtë:





## 4.2. Vaksinimi


Gjatë kësaj periudhe, nga kalendari i obliguar janë dhënë gjithsej **27,329** vakcina, ndërsa vakcina kundër **Covid-19** janë dhënë **29** doza të vaksinës. Sipas muajve pason kjo ndarje:



## 4.3. Shërbimi i Njesisë Diabetike

Njësia diabetike gjatë kësaj periudhe ka ofruar gjithsej **5,522** shërbime shëndetësore për pacient, duke përfshirë vizita për pacient, egzaminime të ECHO abdomenit, matja e glikemisë, vizita për trajtimin e shputës diabetike, etj.


Në grafikonin e mëposhtëm gjeni ofrimin e këtyre shërbimeve në baza mujore:



#### 4.4. Laboratori

Shërbime diagnostike për analiza laboratorike, hematologjike, biokimike dhe në përgjithësi analiza të tjera në laboratorin e QKMF, QMF 1, QMF- Reqanë, QMF Gjonaj dhe QMF Zhur janë kryer gjithsej **71,072** shërbime.


Grafikoni i mëposhtëm paraqet realizimin e këtyre analizave sipas muajve.






#### 4.5. Radiologjia

Shërbime diagnostike radiologjike përfshirë ECHO të gjirit, mamografi, ortopan, RTG, etj., gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjithsej **7,557** shërbime.




Në kuadër të shërbimeve radiologjike të ofruara, vlen të përmendet numri mamografive të realizuara gjatë kësaj periudhe. Në total janë realizuar gjithsej **655** mamografi nga stafi i QKMF, numrin e të cilave të ndara në muaj e gjeni më poshtë:



#### 4.6. Shërbimi Urgjent

Shërbime urgjente të ofruara nga Shërbimi Urgjent në kuadër të QKMF-së, përfshirë vizitat në teren, vizitat ambulatore, transportet për spital, vizitat gjatë aksidenteve nga ekipet e urgjencës, vdekjet e konfirmuara nga ekipet e urgjencës, infuzionet, etj., janë realizuar gjithsej **28,685** shërbime gjatë kësaj periudhe.





#### 4.7. Shërbimet Geriatrike dhe Paliative

Gjatë kësaj periudhe kohore, janë realizuar gjithsej **4,608** shërbime geriatrike, ndërsa **3,030** shërbime të kujdesit paliativ për qytetarët e Komunës së Prizrenit.


Grafikonet e mëposhtme pasqyrojnë numrin e saktë të këtyre shërbimeve të ofruara sipas muajve përkatës.





#### 4.8. Ndërrimi i natës

Në kuadër të ndërrimit të natës ose ndryshe ndërrimit të tretë me anë të të cilit kompletohet shërbimi 24 orë për qytetarët, janë ofruar **54,283** shërbime shëndetësore për pacient. Për secilin muaj veç e veç, keni të paraqitur më poshtë numrin e shërbimeve të ofruara.




#### 4.9. Shërbime stomatologjike

Në kuadër të ktyre shërbimeve ku përfshihen vizitat, mbushjet e dhëmbit, nxjerrjet, inqizimet, etj., janë realizuar gjithsej **28,510** shërbime në kuadër të këtij dikasteri të Kujdesit Parësor Shëndetësor në Komunën e Prizrenit.

Grafika e mëposhtme jep numrin e shërbimeve mujore në këtë department.






#### 4.10. Sars Cov rapid-testet

Në kuadër të QKMF-së dhe QMF-ve në Komunën e Prizrenit janë realizuar gjithsej 2,252 teste të cilat kanë ndihmuar në luftën kundër Covid 19. Duke pasur parasysh kalimin e periudhës pandemike, numri i rasteve të realizuara për këtë fushë ka pësuar rënie të konsiderueshme krahasuar me vitet e kaluara, ashtu siç ka rënë edhe numri i rasteve positive nga këto teste.

Në grafikonin e mëposhtëm parasite raporti midis rasteve negative dhe positive të evidentuara pas realizimit të këtyre testeve.




#### 4.11. Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë (0-3 vjeç)

Gjatë kësaj periudhe, DKSH përmes ekipeve të QKMF ka ofruar një numër të madh të vizitave për këtë kategori. Në total janë ofruar **3,462** vizita të tilla, prej të cilave **2,557** vizita për fëmijë dhe **740** vizita për shtatzëna.

Në kuadër të këtij numri, hyjnë edhe rreth **221** vizita të ofruara për komunitetin RAE për këto kategori.


Më poshtë do të pasqyrojmë këto vizita të ofruara sipas muajve:





#### 4.12. Shërbime të tjera shëndetësore

Në grafikonin e mëposhtëm do të paraqesim edhe numrin total të disa prej shërbimeve të tjera të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe.



#### 4.13. Realizimi i vizitave rutinë në formë Check-upi



Gjatë këtyre muajve, DKSH ka realizuar gjithsej 5 check-upe për sëmundjet e ndryshme.

Më poshtë gjeni check upet e realizuara dhe periudhën se kur janë realizuar të njëjtat.

Emri i Check up-it	Koha e realizimit
1. Check up për zbulimin e sëmundjes së Diabetit	15 dhe 16 prill 2023
2. Check up për zbulimin e sëmundjeve të mëlqisë dhe pankreasit	10 dhe 11 qershor 2023
3. Check up për zbulimin e sëmundjeve të kancerit të gjirit	25 dhe 26 qershor 2023
4. Check up për zbulimin e sëmundjeve të gjëndrrës tiroide	11 dhe 12 nëntor 2023

Më poshtë gjeni të bashkangjitura disa foto të realizimit të këtyre Check-upeve.








## 5. Subvencionet

DKSH gjatë periudhës janar-nëntor 2023 ka pranuar gjithsej 1,243 kërkesa për mbështetje financiare. Prej këtyre kërkesave, 1231 janë aprovuar, 12 janë refuzuar. Për 1231 kërkesat e aprovuara, për 960 nga to janë realizuar pagesat, ndërsa për 271 nuk është realizuar pagesa dhe të njëjtat barten për realizim për vitin e ardhshëm. Për 960 kërkesa të realizuara, është shpenzuar shuma prej 384,000.00 eurosh. Në baza mujore, më poshtë gjeni numrin e kërkesave të pranuar, aprovuara dhe refuzuara.



## 6. Shënimi i Ditëve Botërore

DKSH me aktivitete të ndryshme, ka bërë shënimin e ditëve botërore të përcaktuara me kalendarin botëror të shënimit të këtyre ditëve. Më poshtë gjeni të radhitura ditët botërore për të cilat DKSH ka realizuar aktivitetet e saj.

Emri i ditës botërore	Koha e shënimit të saj	Aktiviteti
Dita Botërore e Kancerit	04 shkurt 2023	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shpërndarja e broshurave vetëdijësuese nëpër institucionet e KPSH</li> <li>2. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor</li> </ol>
Dita Botërore e TBC	24 mars 2023	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Aktivitet vetëdijësues në Sheshin Shadërvan së bashku IKSHP në Prizren</li> <li>2. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor</li> </ol>
Java Botërore e Imunizimit	24-25 prill 2023	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Aktivitet vetëdijësues në Sheshin Shadërvan ku është bërë shpërndarja e fletushkave vetëdijësuese</li> <li>2. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor</li> </ol>
Dita Botërore e Infermierit	12 maj 2023	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Aktivitet në Sheshin Shadërvan</li> </ol>
Dita Botërore e Hipertensionit	17 maj 2023	<ol style="list-style-type: none"> <li>3. Shpërndarja e broshurave vetëdijësuese nëpër institucionet e KPSH</li> <li>1. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor</li> </ol>
Dita Botërore e Mjekut Familjar	19 maj 2023	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pjesëmarrja në ktivitetin e orgnizuar nga Ministria e Shëndetësisë në Prishtinë</li> </ol>
Dita botërore e Duhanit	30 maj 2023	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor</li> </ol>
Dita Botërore e Abuzimit të Drogave	26 qershor 2023	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor</li> </ol>




Dita Botërore e Zembrës	29 shtator 2023	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Aktivitet në Sheshin Shadërvan nga ekipet mobile të QKMF ku është ofruar matja e shtypjes së gjakut si dhe këshilla për qytetarët e rastit</li> <li>2. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor</li> </ol>
Muaji i Kancerit të Gjirit	01-30 tetor 2023	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Çdo fundjavë të këtij muaji, janë realizuar vizita rutinore për gra, ku janë përfshirë vizita specialistike, eho dhe mamografi nga mjeku specialist. Gjithashtu janë realizuar aktivitete vetësjuesuese nëpër shkolla të Komunës së Prizrenit, në shesh si dhe nëpër OJQ të ndryshme që prekin këtë kategori, duke ofruar këshilla e ligjerata për parandalimin e kësaj sëmundjeje. Poashtu, është organizuar edhe një ligjeratë në kuadër të QKMF lidhur me këtë temë</li> </ol>
Dita Botërore e Diabetit	13 nëntor 2022	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Aktivitet në Sheshin Shadërvan nga ekipet mobile të QKMF ku është ofruar matja e sheqerit në gjak si dhe këshilla për qytetarët e rastit</li> <li>2. Ligjeratë e organizuar në QKMF për profesionistët shëndetësor</li> </ol>

Më poshtë do të bashkangjesim edhe disa fotografi nga aktivitetet e ndryshme të realizuara në kuadër të shënimit të këtyre ditëve.









### DIAGNOSTIC CYCLE FOR PERSON-CENTERED GLYCEMIC MANAGEMENT IN TYPE 2 DIABETES

**REVIEW AND AGREE ON MANAGEMENT PLAN**

- Review management plan
- Verify/Re-agree on its scope
- Identify specific and realistic targets of therapy (e.g., hemoglobin A1c)
- Identify factors to avoid hypoglycemia
- Consider patient's individual needs to help to address them
- Consider the patient's perspective

**PROVIDE Ongoing SUPPORT AND MONITORING OF:**

- Adherence with therapy
- Complications (short-term and long-term)
- Quality of life
- Psychological well-being
- Diabetes distress
- Diabetes self-management skills
- Diabetes-related quality of life

**APPLY AND MANAGE THE PLAN**

- Apply the management plan
- Monitor and adjust the plan
- Provide ongoing support and monitoring

**ASSESS AND MANAGE RISKS**

- Low blood glucose
- Hypoglycemia
- Hyperglycemia
- Diabetes complications
- Diabetes distress
- Diabetes-related quality of life

**ADJUST THE PLAN FOR INDIVIDUAL PATIENTS**

- Individualize the plan
- Consider the patient's perspective
- Consider the patient's needs
- Consider the patient's preferences
- Consider the patient's resources
- Consider the patient's environment
- Consider the patient's culture
- Consider the patient's beliefs
- Consider the patient's values
- Consider the patient's goals
- Consider the patient's expectations
- Consider the patient's fears
- Consider the patient's hopes
- Consider the patient's dreams
- Consider the patient's wishes
- Consider the patient's desires
- Consider the patient's needs
- Consider the patient's wants
- Consider the patient's requirements
- Consider the patient's demands
- Consider the patient's expectations
- Consider the patient's hopes
- Consider the patient's dreams
- Consider the patient's wishes
- Consider the patient's desires
- Consider the patient's needs
- Consider the patient's wants
- Consider the patient's requirements
- Consider the patient's demands

**PROVIDE Ongoing SUPPORT AND MONITORING OF:**

- Adherence with therapy
- Complications (short-term and long-term)
- Quality of life
- Psychological well-being
- Diabetes distress
- Diabetes self-management skills
- Diabetes-related quality of life

**APPLY AND MANAGE THE PLAN**

- Apply the management plan
- Monitor and adjust the plan
- Provide ongoing support and monitoring

**ASSESS AND MANAGE RISKS**

- Low blood glucose
- Hypoglycemia
- Hyperglycemia
- Diabetes complications
- Diabetes distress
- Diabetes-related quality of life

**ADJUST THE PLAN FOR INDIVIDUAL PATIENTS**

- Individualize the plan
- Consider the patient's perspective
- Consider the patient's needs
- Consider the patient's preferences
- Consider the patient's resources
- Consider the patient's environment
- Consider the patient's culture
- Consider the patient's beliefs
- Consider the patient's values
- Consider the patient's goals
- Consider the patient's expectations
- Consider the patient's fears
- Consider the patient's hopes
- Consider the patient's dreams
- Consider the patient's wishes
- Consider the patient's desires
- Consider the patient's needs
- Consider the patient's wants
- Consider the patient's requirements
- Consider the patient's demands



## 7. Aktivitete të tjera

Përgjatë kësaj periudhe, DKSH ka realizuar edhe një numër të konsiderueshëm aktivitetesh të ndryshme. Më poshtë do të shpalosim disa prej këtyre aktiviteteve.

Gjatë muajit janar, është bërë shpërndarja e mirënjohjeve për 100 punëtor të QKMF për të njohur kontributin e tyre me punën gjatë vitit 2022.

DKSH ka marrë pjesë në takimet e thirrura nga MSH lidhur me fillimin e implementimit të pilot projektit për Zonimin e Pacientëve, projekt i ri ky nga MSH ku do të mundësohet zonimi si dhe përzgjedhja e mjekut familjar nga qytetarët e Komunës së Prizrenit.

Me datë 10.03.2023, pas votimit dhe miratimit në Asamblenë Komunale të Komunës së Prizrenit, kemi marrë konfirmimin e ligjshmërisë nga ana e Ministrisë, lidhur me Statutin e QKMF, me ç'rast kemi marrë aprovimin se i njëjti është në përputhje me legjislacionin.

Me datë 15.03.2023 është pranuar donacioni i paisjeve mjekësore të dhuruara nga KFOR-i Italian, paisje të cilat kryesisht kanë qenë të dedikuara për Shërbimin Urgjent.

Janë realizuar vizitat sistematike në shkollat e Komunës së Prizrenit për nxënësit e klasave të para, të pesta dhe të nënta.

Gjatë muajit gusht kemi pranuar edhe një donacion me paisje mjekësore nga AQH.

Më 13.09.2023 është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi ndërmjet DKSH dhe DKA për dhënjen në shfrytëzim të përkohshëm të hapësirave të AMF Novosellë për zhvillimin e procesit mësues, deri në përfundim të punimeve në shkollën e këtij fshati.

Gjatë muajit tetor, është bërë promovimi i shërbimit të ri të ofruar nga DKSH përmes QKMF, që ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve shëndetësore në shtëpi për personat me aftësi të kufizuara të cilët nuk mund të frekuentojnë hapësirat e QMF-ve. Ky shërbim është shtuar krahas ofrimit të shërbimeve që janë dhënë më herët në kuadër të kujdesit paliativ dhe geriatrik.

Në muajin nëntor është realizuar punësoria lidhur me të gjeturat nga vizitat sistematike të nxënësve në shkollat e Komunës së Prizrenit.

Gjatë muajit dhjetor, në mënyrë solemne është përruar emri i QKMF-së me emrin e DR. Nexhip Berisha, në përvjetorin e vdekjes së tij.

Më poshtë do të bashkangjijim edhe disa fotografi lidhur me aktivitetet e realizuara.





Drejtoria Komunale e Shëndetësisë  
Prizren

Janar 2024

V.V.